



Shkruan: Zenel Latifi

Të jesh në mesin e njerëzve dhe shoqërisë edhe kur trupi yt nuk gjendet aty, të ndihet aroma jote dhe të përmendet emri yt përgjithmonë, të jesh i gjallë edhe pas vdekjes është vërtetë një gjë që të rrit krenarinë. Gjithashtu kur mungesa jote vërehet, atëherë dije se ti ke pasur vlerë të madhe në rrethin ku jetoje, sepse të pavlerët nuk nevojiten asgjë, përpos një trup që vetëm e rëndon tokën dhe kërkon prej mirësive të saja pa u lodhur fare. Burrë i vërtetë ishte që nga lindja, sepse na erdhi nga një familje patriotësh, të cilët luftuan pa u ndalur kundër atyre që donin t'na shihnin të mbuluar me qefin. E vazhdoi misionin e stërgjyshërve duke mos kursyer as pikën e fundit të gjakut, pa frikë u mundua bashkë me shokët e tij dhe organizoi plane të ndryshme për ta mbrojtur atdheun që e kishte amanet nga gjyshi dhe babai i tij. Zemra e tij ishte e mbushur plot dashuri për atdheun dhe në të nuk kishte vend për frikë. Si një luan mernte pjesë në duela kundër serbëve të cilët i mposhtte burrërisht dhe asnjëherë s'e ktheu shpinën të largohet nga beteja. Sa e sa herë u pengua nga aktivitetet e tij, por përkushtimi i madh që e kishte nuk e lejoi të japë dorëheqje, atij çdoherë vetëm se i shtoej vullneti për punë. Kush tha se Zahiri vdiq nuk e tha të vërtetën dhe gaboi shumë. Armiku të bëri kurthe dhe mendoi se të vrau, por jo! Ti jeton! Gjendesh në zemrat tona, ne s'të harrojmë kurrë ty, sikur ti, që nuk na le dhe nuk na harrove. E dhe më të vlefshmen për ne, jetën tënde! Ti je ai që edhe pse të burgosën disa herë, nga dritaret e burgut shikoje dheun e shtrenjtë dhe vazhdove me veprat e tua të palodhshme duke e liruar atë nga robëria shumëvjeçare dhe nga okupatori sllav. Përveç se Zahiri na ishte një trim i fuqishëm ai ishte edhe burrë i mençur që i pajtonte gjaqet, gjë që për

njerëzimin është vepër madhështore, sepse të përqafohen dy vëllezër që konsideroheshin "kundërshtarë" mes vete ishte një ndjenjë mbresëlënëse që shoqërohej me lot në sy. Eh, këtë e bëri Zahir duke pajtuar shumë hasmëri që sollën shumë vrasje më herët, kurse ky solli vëllazërimin e tyre. Trimëria bëhet edhe më e bukur kur asaj i shtohet dituria dhe inteligjenca. Zahir s'e la anash talentin e tij dhe ai e formoi Shtabin e Njesisë Guerile në Orllan, me të cilën e ndihmoi popullin e vet, kurse për ta ngritur lart nderin e Shqiptarisë, ai bëhet një nga themeluesit e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe anëtar i tij. Mirëpo jo gjithkush ia do të mirën këtyre trimave si ky. Derisa udhëtonte nga Prishtina për në Vushtri, i dolën në pritë serbët me të cilët luftoi deri në vdekje duke u bërë dëshmor i Kombit Shqiptar. Tridhjetë e pesë vitet që jetoi u shndërruan në tridhjetë e pesë yje, që na ndriçojnë rrugën tonë drejt të ardhmes. Emri "Zahir Pajaziti" u bë sinonim dhe simbol i trimërisë dhe burrërisë dhe çdoherë që përmendet emri i tij neve na kujtohet sakrifica për atdheun dhe na shtohet dashuria për të. Ndërroi jetë në mënyrë madhështore duke na lënë një shembull se si duhet luftuar dhe na la amanet ta ruajmë Kosovën dhe Shqipërinë që s'i ndau kurrë nga zemra dhe shpirti i tij.

Zenelabedin Latifi, Kumanovë - Maqedoni

*Kjo ese është botuar në librin më të ri kushtuar heroit Zahir Pajaziti (ese dhe poezi) "Rruga më e mirë, pa thënë lamtumirë".*